



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 36/2011
Prishtinë, më 18.10.2011, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Hashim Deshishku, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Brikena Hoxha - konsulente dhe Brisilda Hoti - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11. 10. 2011;
3. Miratimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë;
4. Miratimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës;
5. Miratimi i fushëveprimit të Komisionit;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11. 10. 2011

Procesverbali i mbledhjes datës 11. 10. 2011 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë

Kryetari – Njoftoi se komisionet e përhershme e kishin shqyrtuar raportin me amendamente, dhe përveç vërejtjeve të Komisionit për Integritet Evropian, nuk kishte tjera. Komisioni për Integritet Evropian ka rekomanduar riformulimin e përkufizimeve “Qeveri” dhe “Transit” që janë të përkufizuara me amendamentin 12, lidhur me nenin 3 të Projektligjit.

Riformulimet e rekomanduara nga Komisioni për Integritet Evropian janë:

Qeveri – do të thotë Qeveria ose ndonjë organ publik (agjenci shtetërore) në territorin e shtetit të origjinës ose të eksportit;

Transit – nënkupton transportin e artikujve me përdorim të dyfishtë, me origjinë nga shtetet jashtë Republikës së Kosovës, që hyjnë dhe kalojnë përmes territorit doganor të Kosovës me destinacion jashtë këtij territori.

Lutfi Zharku – Përkufizimi i termit “Transit” është i kufizuar, sepse përshin vetëm mallrat me përdorim të dyfishtë. Propozoi të zëvendësohet togfjalëshi “artikuj me përdorim të dyfishtë” me togfjalëshin “mallrave, përfshirë ato me përdorim të dyfishtë”.

Komisioni përkrahu propozimin e deputetit Lutfi Zharku dhe kërkoi që ky propozim të harmonizohet me Komisionin për Integritet Evropian.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni miratoi raportin me rekomandime të Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë, duke përfshirë edhe rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian.

4. Miratimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës

Kryetari – Njoftoi se Komisionet e përhershme e kishin shqyrtuar Raportin me amendamente, dhe përveç vërejtjeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk kishte të tjera. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka përkrahur amendamentin 41, për shkak të implikimeve buxhetore shitesë dhe ka rekomanduar tri amendamente me ndryshimet si në vijim:

Amendamenti 1, neni 37, hiqet fjalia e dytë e këtij neni, si në vijim: “I njëjti duhet të propozojë të punësojë staf profesional dhe me eksperiencë të cilët kanë kapacitete të kryejnë detyrat e përcaktuara me këtë ligj.”; **Amendamenti 2**, neni 38, në paragrafin 6.12, hiqet fjalia e dytë, si në vijim: “Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të

zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.”; **Amendamenti 3**, neni 39, paragrafi 16, hiqet në tërësi.

Lutfi Zharku –Theksoi se amendamenti 2 nuk përmban implikime shtesë buxhetore dhe nuk duhet të përkrahet.

Pas diskutimeve Komisioni përkrahu amendamentet 1 dhe 3 të rekomanduara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ai po ashtu përkrahu rekomandimin për heqjen e amendamentit 41, por nuk e përkrahu amendamentin 2 të rekomanduar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse paragrafi 6.12 i nenit 38 nuk ka të bëjë me buxhet dhe financa.

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni për Legjislacion ka sugjeruar të rishikohet amendamenti 45, sepse përmbajtja e tij është e paqartë, konfuze dhe duhet të harmonizohet me Ligjin për shërbimin civil.

Pas diskutimit Komisioni përkrahu propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe vendosi që në amendamentin 45 të hiqet teksti “Drejtori i përgjithshëm emërohet me një mandat tre (3)-vjeçar me mundësi vazhdimi”.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni miratoi raportin me rekomandime të Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës.

5. Miratimi i fushëveprimit të Komisionit

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se është duke u punuar Rregullorja e punës së Kuvendit dhe në të do të përcaktohet fushëveprimi i komisioneve. Kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i japin sugjerimet e tyre lidhur me përmbajtjen që duhet të përshkruhet në fushëveprimin e Komisionit.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Anëtarët e Komisionit, deri në mbledhjen e radhës, të paraqesin propozimet e tyre për përmbajtjen e fushëveprimit të Komisionit.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit